



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 12

Prishtine, 27.05.2015. me fillim në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, kryetare, Agim Çeku, zëvendës kryetar i parë, Mufera Sinik, zëvendës kryetar i dytë, Saša Milosavljević, Agim Kukaj, Fisnik Ismajli, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi, anëtarë.

Munguan: Rustem Berisha, anëtar

Pjesëmarrësit e tjerë: vëzhguesi i OSBE-së dhe anëtar i Këshillit Konsultativ për komunitete
Stafi për përkrahje: koordinatori i komisionit dhe zyrtari i fushës

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković, kryetare e komisionit

Për mbledhje u propozua ky :

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr.05/L-32 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;
3. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr.05/L-33 32 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr.05/L-35 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin prokurorial të Kosovës, , me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

5. **Shqyrtimi i Projekt ligjit nr.05/L-34 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për prokurorin e shtetit, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;**
6. **Shqyrtimi i Projekt ligjit nr.05/L-36 për kompensimin e viktimave të krimit, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;**
7. **Të ndryshme.**

1. **Kryesuesja,** konstatoi se rendi i ritës u miratua pa vërejtje dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së dytë të renditi të ditës:

2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-32 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;**

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.05/L-32 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për gjykatat, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i propozon Kuvendit që i njëjti të miratohet në shqyrtimin e dytë.

Kryetarja e hapi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës:

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-33 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;**

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.05/L-33 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, , me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit nuk cenon të drejtat e komuniteteve,prandaj i propozon Kuvendit që i njëjti të miratohet në shqyrtimin e dytë.

Kryetarja e hapi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-35 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin prokurorial të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.05/L-35 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin prokurorial të Kosovës, , me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, me amendamentet e komisionit funksional nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i rekomandon Kuvendit miratimin në shqyrtim të dytë.

Kryetarja e hapi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-34 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për prokurorin e shtetit , me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.05/L-34 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për prokurorin e shtetit, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, me amendamentet e komisionit funksional nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i rekomandon Kuvendit miratimin në shqyrtim të dytë.

Kryetarja e hapi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Projekt ligjit nr.05/L-36 për kompensimin e viktimave të krimit, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit;

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr.05/L-36 për kompensimin e viktimave të krimit, me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacionin, Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, me amendamentet e komisionit funksional nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, prandaj i rekomandon Kuvendit miratimin në shqyrtim të dytë.

7. Të ndryshme

Kryesuesja: në praktikën e deritashme në procedurën e shqyrtimit të projektligjeve, ekzistojnë lëshime serioze në përkthimin e të gjitha projektligjeve dhe akteve nënligjore në gjuhën serbe.

Shpesh herë janë të pakuptimtë dhe nuk i përmbushin standardet gjuhësore, kështu që në këtë mënyrë mbasin në interpretimin e lirë të përkthyesve, që rrezikon statusin e barabartë të gjuhës serbe si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës. E gjithë kjo me qëllim të përmirësimit, respektimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit në praktikë dhe statusit të barabartë të gjuhës serbe në Republikën e Kosovës edhe në legjislacionin e tanishëm por edhe të ardhshëm.

Me qëllim të garantimit që interesat e komuniteteve do të trajtohen në nivelin adekuat, në pajtim me nenin 78 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 1.1. të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, propozoj që komisioni ti dërgojë Kryesisë së Kuvendit një kërkesë me rekomandim që të obligohet Zyra Ligjore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të ndërmerr aktivitete për forcimin e kapaciteteve të institucioneve dhe progres në proces të hartimit të legjislacionit dhe zbatimit të drejtë të standardeve të politikës gjuhësore në të gjitha nivelet, me qëllim të tejkalimit të kësaj problematike, që konsiderohet e domosdoshme dhe në interes të komuniteteve.

Pas sugjerimit, propozimi i kryetares është miratuar dhe komisioni nxjerr këtë:

Përfundim

Ngarkohet shërbimi i Komisionit që t'i dërgojë Kryesisë së Kuvendit një kërkesë me rekomandim, në pajtim me propozim të miratuar.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Predsednikkomisije

Jasmina Živković